

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 2286 Rep.
Nr. 1524 Kol.



(Për transferimin e aksioneve te shoqërisë "A.S.K" Oil Sh.a)

Sot ne Tirane me date 29/09/2011 (dymijë e nëntë), përpara meje noterit te Dhomës se Noterëve Tirane, u paraqiten personalisht palët e mëposhtme:

SHITESI: Z. Hamdi Pasha, shtetas shqiptar, lindur ne Thumane, Kruje, me 05.03.1966, mbajtës i leternjoftimit me nr.027818065, titullar i 22 aksioneve qe përfaqesojne 22% te kapitalit te Shoqërisë, madhor e me zotësi te plote për te vepruar.

Dhe

BLERESI: Z. Andi Kume, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, më 11.12.1983, mbajtës i leternjoftimit me nr. 029558735, titullar i 45 aksioneve qe përfaqesojnë 45% te kapitalit themeltar te Shoqërisë, madhor e me zotësi te plote për te vepruar.

MEQENESE

- a) Shitësi zotëron 22 aksioneve te shoqërisë te cilat përbejnë 22% te kapitalit te Shoqërisë "A.S.K" Sh.a (Shoqëria), shoqëri aksionare e themeluar dhe qe ushtron aktivitetin e saj ne baze te legjislacionit shqiptar, regjistruar ne Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare te Regjistrimit, mbajtëse e NUIS - K82109004K.
- b) Shoqëria ka një kapital te regjistruar ne vlerën Lek 2.000.000 (dy milion) i ndare ne 100 (njëqind) aksione me vlerë nominale 20.000 (njëzet mije) lek secili;
- c) Shitësi dhe Blerësi kane rënë dakord qe Shitësi ti shesë Blerësit 22 aksione qe përbejnë 22% te kapitalit te Shoqërisë;
- d) Blerësi dëshiron te blejë nga Shitësi aksionet e specifikuara me sipër;
- e) Aksionet shiten (transferohen) me vlerën e tyre nominale siç është përcaktuar me poshtë ne këtë kontrate.

Meqenëse ekzistojnë kushtet me sipër, palët bien dakord për sa me poshtë vijon:

1. Objekti i Kontratës

Sipas kushteve te parashikuara ne ketë Kontrate, Shitësi transferon tek Blerësi dhe ky i fundit blen nga Shitësi 22 (njëzet e dy) aksione qe përbejnë 22% te kapitalit te Shoqërisë;

2. Çmimi i shitjes

Aksionet shiten (transferohen), kundrejt vlerës se tyre nominale prej Lek 20.000 (njëzet mijë) lek, për çmimin total prej 440.000 (katerqind e dyzete mijë), i cili është paguar plotësisht nga Blerësi jashtë zyrës noteriale.

3. Transferimi i pronësisë mbi aksionet

Pronësia mbi aksionet transferohet menjëherë nga Shitësi tek Blerësi ne momentin e nënshkrimit te kësaj kontrate.

4. Te ndryshme

Pas transferimit te pjesëve te kapitalit, Blerësi behet pronar i ligjshëm i 22 (67 ne total) aksioneve qe përbejnë 22% (67 % ne total) te pjesëve te kapitalit te Shoqërisë dhe ushtron të gjitha të drejtat qe ligji i njih zotëruesit të aksioneve të përcaktuara në objektin e kësaj kontrate si nga pikëpamja e ushtrimit të së drejtës së votës dhe të pjesëmarrjes në shpërndarjen e fitimeve.

Shitësi humbet te gjithë te drejtat qe buronin nga aksionet e shitura dhe deklaron se nuk ka pretendime te asnjë lloji ndaj shoqërisë dhe/ose aksionareve te saj.

5. Baza Ligjore

Kjo kontrate do te interpretohet dhe zbatohet ne përputhje me dispozitat e Kodit Civil te Republikës se Shqipërisë dhe te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe çdo dispozite tjetër ligjore te cilës i behet referim ne ketë kontrate.

Kjo kontrate pasi u lexua prej meje Noterit, u gjet ne përputhje me vullnetin e lire e te plote te palëve dhe u nënshkrua rregullisht prej tyre ne praninë time ne katër kopje origjinale dhe unë Noteri e vërtetoj ketë sipas ligjit.

SHITËSI

Hamati Basha





BLERËSI

Arshi Kame dhe M. Tulu



